



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 29/2015

Prishtinë, më 30.7.2015, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Enver Hoti. - anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Dardan Abazi - INDEP dhe Lejla Selimi – OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr.05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 029 për Patenta;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr.05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 026 për Markat Tregtare;
4. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin Nr.05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 029 për Patenta

Kryetari Muhamet Mustafa njoftoi se Komisionet e përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 029 për Patenta dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje apo propozim.

Besim Beqaj tha se raportet e Komisioneve të përhershme nuk i kemi, por meqenëse kryetari na njoftoi se amendamentet e Komisionit nuk kanë pësuar ndryshim, ne e përkrahim Raportin me rekomandime.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr.05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 029 për Patenta;

2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

Kryetari kërkoi nga Komisioni ta përkrahin për të futur sot në lexim të dytë ky projektligj, sepse tha ai, kjo kërkohet edhe në Raport të Progresit edhe pasi që s'kemi vërejtje.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit Nr.05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 026 për Markat Tregtare;

Muhamet Mustafa, kryetar, njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisionet e përhershme, përveç Komisionit për legjislacion, e kanë shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 026 për Markat tregtare dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje apo propozim.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka komunikuar me kryetaren e Komisionit për legjislacion, e cila do të konsultohet me anëtarët e Komisionit për Legjislacion, dhe në seancë plenare do ta paraqes raportin me rekomandime të Komisionit për Legjislacion. Më tutje z.Mustafa potencoi se ky Raport me amendamente ka mbet pa u shqyrtuar nga Komisioni për Legjislacion për shkak të një gabimi në procedim nga administrata apo zyrtarët kompetentë të atij Komisioni.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr.05/L-040 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L- 026 për Markat tregtare;

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

Kryetari kërkoi nga Komisioni edhe për këtë projektligj që ta përkrahin për ta futur sot në lexim të dytë.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

4. Të ndryshme.

Muhamet Mustafa tha se pas propozimit të deputetit Raif Qela për plotësim të Amendamentit 21 për Projektligjin për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive, dje jemi takuar me përfaqësues të MZHE-së, KPM-së, ARKEP-it, dhe AMPEK-ut. Në këtë takim, pas diskutimeve u propozua që Amendamentit 21, në paragrafin 2 t'i shtohet teksti si në vijim:

“KPM-ja do t'i përcaktojë procedurat dhe kushtet e dhënies më koncesion të multipleksëve përkatës lokalë dhe rajonalë.”

Propozimi i kryetarit Muhamet Mustafa u përkrah nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa